

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“EG2ENERGY” sh.p.k

Tiranë më datë 11 / 11 /2022

NENI 1

Shoqëria Tregtare “EG2ENERGY” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

NENI 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “EG2ENERGY” sh.p.k

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive në fushën e energjisë elektrike


Konkretisht:

1. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike, nga impiante dhe parqe fotovoltaike;
2. Ndërtimi, operimi dhe vënia në punë e parqeve fotovoltaike;
3. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshe, impiantet fotovoltaike, etj pa u kufizuar;
4. Ndërtimi, operimi dhe vënia në punë e hidrocentraleve;
5. Prodhimi i gazit; shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve;
6. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja e energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet;
7. Ndërtimi i parqeve fotovoltaike dhe prodhimi i energjisë nga burimet e rinovueshme;
8. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve;
9. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme;
10. Importi dhe sekporti i mallrave dhe pajisjeve të teknologjisë bnë fushën e energjetikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e hidrocentraleve;
11. Mirëmbajtja e centraleve energjetike, etj.

Shoqëria mund të ushtrojë çdo lloj aktiviteti tregtar që legjislacioni i Republikës së Shqipërisë nuk e ndalon.

NENI 4

Selia e Shoqërisë



Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Barrikadave; Qendra Turdiu; K2; N17, Tiranë, Shqipëri.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën **10.000.000 (dhjetë milion) lekë.**

Kapitali ndahet në 1 (një) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. z. Mario TERENZI, lindur më 02.05.1973, në POMEZIA, Itali i Shtetësisë Italiane, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Pasaportës nr. YA7614496, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100 % të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortaku themelues në total.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është **z. Mario TERENZI**, lindur më 02.05.1973, në POMEZIA, Itali i Shtetësisë Italiane, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Pasaportës nr. YA7614496, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, entit publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU

Mario TERENZI

